

QENDRIM PUBLIK

Reforma Zgjedhore larg aspiratave dhe pritshmërive për një reformë të vërtetë, të thelluar dhe gjithëpërfshirëse

Që prej Reformës Zgjedhore të arrirë në vitin 2012, pas disa përpjekjesh të stërgjatura dhe të dështuara, nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga Lidhshiptet politike pritej një reformë zgjedhore integrale dhe gjithëpërfshirëse në çështjet zgjedhore. Një reformë, jo thjesht si një përmirësim i kuadrit ligjor, por si një proces i thelluar dhe i plotë që do të vendoste hullinjtë e rikthimit të besimit qytetar tek demokracia dhe shteti i së drejtës.

Në historikun e tyre, përpjekjet për reformim sipas zotimeve politike dhe kërkesave nga aktorët vendas dhe partnerët strategjikë, u pasuan në fakt nga një periodicitet disa vjeçar krizash politike. Në këtë të fundit, gjatë së cilës janë shënuar precedentë të disatë të një demokracie tranzicionale dhe në krizë, ndër elementët më dramatikë përmenden funksionimi i parlamentit me numër të reduktuar anëtarësh dhe kalimi i të gjithë qeverisjes vendore në duart e vetëm një partie politike.

Në një situatë mungese totale të dialogut politik të rënduar, të rënduar më pas edhe nga mungesa e faktorit kohë në raport me zgjedhjet e vitit të ardhshëm, u gjet si zgjidhje krijimi i Këshillit Politik me synim adresimin, përsa të ishte i mundur, e problematikave në çështjet zgjedhore.

Ky model i gjetur, në zhvillim të përgjegjësive dhe të detyrimeve të faktorit politik e institucional, për kryerjen e reformimit të kuadrit ligjor **rezultoi një hap zhgënjyes për nga pritshmëritë, si për nga mënyra e funksionimit të tij ashtu dhe nga tematika e çështjeve të mbuluara.**

Megjithatë, më shqetësues mbetet fakti se edhe ky model po luhetet drejt dështimit për shkak se **diskursi i lidhshipteve politike vazhdon të mbetet i mbyllur në agjendat individuale e të ngushta të dy partive kryesore**, duke kërcënuar edhe atë rezultat dhe kontribut minimal të mundshëm që mund të arrihet.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania), si një organizatë që ka kontribuar me opinione dhe ekspertizën e vet në këtë proces reformues, sikundër dhe në ata pararendës, më një përvojë të gjerë nga vëzhgimi në vijimësi i proceseve zgjedhore, në këto rrethana, shprehet se ndonëse pritshmëritë nga veprimtaria dhe kontributi i Këshillit Politik janë minimaliste, **ai duhet të konkludojë në një material ligjor, për aq sa ai gëzon dakortësi të plotë politike.**

Së paku, funksionimi i këtij Këshilli Politik, **të shënojë dhe të përbëjë hapin e parë të suksesshëm në vendosjen e dialogut politik dhe të rikthimit institucional të këtij dialogu**, e cila është rruga vetme e zgjidhjes së ngërçeve dhe problemeve në një demokraci.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ky hap i vogël pozitiv, pas një ecurie hapash mbrapa, duhet të ketë si objektiv madhor e të fundëm një reformë zgjedhore integrale dhe të thelluar për shumë çështje emergjente. Është e domosdoshme që ky objektiv të marrë sa më **parë mbështetjen prej deklaramit të qartë të vullnetit politik nga Lidhshipti i partive kryesore se ai do të vazhdojë të peshojë si detyrë parësore mbi Kuvendin e Shqipërisë në legjislaturën e re pas zgjedhjeve të ardhshme.**

Gjithashtu, në këtë drejtim, KRIIK bën thirrje dhe nxit palët që, përtej ecurisë së këtij Këshilli, në vazhden e dialogut të mund të vazhdojnë shkëmbimin e opinionëve dhe të diskutimeve për mundësinë e ndërmarrjes së ndryshimeve të tjera të ardhshme.

Në konsideratën e KRIIK, pikënisja për një reformë zgjedhore të suksesshme në funksion të kthimit të besimit qytetar, **mbetet reformimi i trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe transparenca financiare e veprimtarisë së partive politike.**

Çdo diskutim tjetër mbart rëndësi madhore, por parakushtëzohet në mënyrë determinuese nga këto dy tematika.

Duket qartazi se respektimi i standardeve në procesin zgjedhor të ardhshëm edhe një herë do të jetë në varësi të vullneteve politike, dhe jo të një mekanizmi ligjor-institucional si garanci mbi palët.

Ndaj, si bashkëautorë dhe bashkëpërgjegjës të procesit të ardhshëm zgjedhor, KRIIK iu bën thirrje paraprakisht lidhësive politike se është e domosdoshme që të tregojnë maturi në periudhën para dhe gjatë zgjedhore, duke marrë në konsideratë shmangien e të gjithë precedentëve negativë dhe antiligjorë të ndodhur më parë.

Veçanërisht dhe më konkretisht, në mungesë të kuadrit ligjor përkatës, **KRIIK nxit forcat politike dhe çdo aktor tjetër politik në ofrimin e transparencës së plotë të veprimtarisë financiare**, duke filluar që nga kjo periudhë aktuale, dhe **më pas edhe për ndërmarrjen e një auditit post zgjedhor.**

Gjykohet se mirëfunksionalizimi i këtyre dy instrumentave, përtej gjendjes së sotme, mund të shërbejnë dhe të ndihmojnë në rikthimin e besimit qytetar tek procesi zgjedhor dhe ai politik e institucional i lidhur me të.

Transparenca e veprimtarisë financiare, e detajuar, në kohë reale dhe paraprake, është instrumenti më i rëndësishëm i partive dhe grupimeve politike për t'iu bërë me dije qytetarëve shqiptarë se **cilat janë interesat që i mbajnë të angazhuar apo të lidhur politikanët dhe mbi cilën bazë dhe interesa ndërtohen ofertat elektorale** që iu serviren qytetarëve. Transparenca e plotë do të reflektonte, gjithashtu, sinqeritetin e vullneteve të tyre dhe se sa të përkushtuar ata janë ndaj fatit të vendit.

Besimi qytetar tek demokracia dhe institucionet, nuk mund të fitohet falë thirrjeve apo, më keq, falë propagandës boshe, por duke dëshmuar transparencë të plotë financiare të partive politike dhe të çdo aksioni politik si dhe transparencë të plotë të veprimtarisë së institucioneve zgjedhore dhe çdo operatori apo institucioni të përfshirë.

Në përfundim, duke kërkuar që dakordësia politike mos të jetë vula e ardhshme e çertifikimit të rezultatit zgjedhor dhe bashkë me të edhe të kimit zgjedhor, **KRIIK bën thirrje dhe kërkon angazhimin e lidhësive politike në ndërmarrjen e një auditit post zgjedhor, menjëherë pas zgjedhjeve të ardhshme.**

Duke risjellë në kujtesë se diskutimi për auditimin e procesit ka qenë një objekt i vazhdueshëm diskutimi në fund të çdo procesi të mëparshëm zgjedhor, palët kanë sot kohën e nevojshme në dispozicion për të nisur dhe diskutuar mbi teknikalitetet e ndërmarrjes së këtij auditit, si një proces pas-zgjedhor i ardhshëm.

Një proces auditimi i plotë, për më tepër, do të shërbejë **për të projektuar akoma më mirë piketat dhe nivelin e thellësisë së ndërhyrjes në reformën zgjedhore të pritshme në legjislaturën e re**, menjëherë pas zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Tiranë, më 31.05.2020!